

01-275



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 dhe të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr.391/02-153214/24 dt. 19.11.2024, të pronarit Tahir Berisha nga Prishtina me adresë në rrugën “Afrim Zhitija”, hyrja nr 1. për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për hapësirën banesore të shndërruar në hapësirë afariste, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 03.12.2024, lëshon këtë:

C E R T I F I K A T Ë E P Ë R D O R I M I T

I. I LEJOHET pronarit Tahir Berisha nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-153214/24 dt. 19.11.2024, përdorimi i hapësirës banesore të shndërruar në hapësirë afariste, e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale O-71914059-10017-0-752-1-2-0, me sipërfaqe prej 38.00 m², Zona Kadastrale Prishtinë e cila ndodhet në katin për dhese të ndërtesës shumë banesore me etazhitet B+P+5ET, në Lagjen “Kodra i Diellit”, rruga “Afrim Zhitija” hyrja nr.1, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-23560 dt. 02.07.2012 të lëshuar nga kjo Drejtori.

II. Hapësira e shndërruar nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Afrim Zhitija” hyrja nr. 1 në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e hapësirës banesore të shndërruar në hapësirë afaristë në evidencat e regjistrit kadastral.

A r s y e t i m

Pronari/investitori Tahir Berisha nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr.391/02-153214/24 dt. 19.11.2024, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për hapësirën banesore të shndërruar në hapësirë afariste, e cila ndodhet në katin për dhese të ndërtesës shumë banesore me etazhitet B+P+5ET, në Lagjen “Kodra i Diellit”, rruga “Afrim Zhitija” hyrja nr.1, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-23560 dt. 02.07.2012, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar:

- Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të objektit investues nga komisioni profesional i emëruar nga kjo Drejtori sipas Vendimit nr. 05 Nr. 351/04-75269/24 dt. 23.09.2024.
- Dokumentacionin përcjellës, kopjen e planit, certifikatën e njësisë kadastrale, atestet e materialeve, certifikatat, etj.

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e komisionit profesional për pranimin teknik të ndërtesës, ka konstatuar se:

Me vendimin nr. 05 Nr. 351/04-75269/24 dt. 23.09.2024 është emëruar Komisioni për pranimin teknik të lokalit në përbërje prej tre antarëve. Komisioni ka filluar punën menjëherë, ku secili prej antarëve ka hartuar raport individual.

Njëkohësisht është konstatuar se objekti investues është ndërtuar në pajtim me vendimet e cekura më lartë dhe dokumentacionin tjetër teknik dhe se i njëjti përmbushë normativat dhe standardet, aplikimi i të cilave është i domosdoshëm me rastin e ndërtimit të objekteve të tilla, për çka edhe ka propozuar që Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, t'i lëshoj certifikatën e përdorimit, andaj kjo Drejtori vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht hapësira banesore e shndërruar në hapësirë afariste mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që hapësira banesore e shndërruar në hapësirë afariste mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuarit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,

05 NR. 391/02-153214/24 DT. 03.12.2024

Zyrtari,
Berim Osmanaj



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

